



## **VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI**

**Data e miratimit: 17 tetor 2017**

**Numri i lëndës: 2016-33**

**Agron Bytyçi**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 17 tetor 2017, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese  
Z. Guénaél METTRAUX, anëtar  
Znj. Elka ERMENKOVA, anëtare

Ndihmuar nga  
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi me 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### **I. PROCEDURAT PRANË PANELIT**

1. Ankesa është regjistruar në Panel me datën 20 dhjetor 2016.

### **II. FAKTET**

2. Faktet e lëndës të paraqitura nga ankuesi mund të përmbliidhen si më poshtë:
3. Ankuesi, Agron Bytyçi, ka marrë pjesë në Gjykatën Themelore në Prizren, me 1 korrik 2016, në një seancë dëgjimore lidhur me kërkesën për shkurorëzim nga gruaja e tij. Me 3 tetor 2016 ishte zhvilluar një seancë tjetër lidhur me këtë çështje, kur z. Bytyçi nuk ishte i pranishëm

pasi nuk ishte në dijeni të seancës dëgjimore dhe ka thënë se nuk mori thirrjen standarde për paraqitje në gjyq.

4. Çështja ishte diskutuar përsëri me 11 tetor 2016, kur gjykata e kishte miratuar kërkesën për shkurorezim. Ankuesit i ishte besuar kujdesi për fëmijën e çiftit, El. B., ndërsa znj. Bytyçi i ishte mundësuar kontakti me fëmijën një herë në muaj.
5. Ankuesi ka deklaruar se me 13 qershor 2016, prokurori nga Kukësi, Shqipëri, ka pyetur z. S. S., babain e ish bashkëshortes së ankuesit, nëse do të ishte i gatshëm ta çonte atë për ta parë fëmijën e saj një herë në muaj.
6. Ankuesi gjithashtu ka deklaruar se prokurori e ka pyetur z. S.S. nëse znj. Bytyçi do të kthehej te bashkëshorti i saj në Prizren. Z. S.S. është përgjigjur se vajza e tij nuk do të kthehej kurrë te bashkëshorti i saj në Kosovë.
7. Z. S.S. thuhet se ka shtuar se edhe ai dhe vajza e tij ishin thellë në borxh si rezultat i procedurave të shkurorezimit. Po ashtu nga faktet e paraqitura nga ankuesi duket se znj. Bytyçi nuk e kishte vizituar djalin e saj në Prizren, e as nuk ka ndonjë synim ta bëjë atë.
8. Në këtë mënyrë ankuesi pretendon se znj. Bytyçi e ka braktisur fëmijën e saj dhe se kështu ajo ka kryer një vepër penale që është e dënueshme deri në tre vjet burgim.

### **III. ANKESË**

9. Ankuesi pohon se z. S.S. e ka korruptuar gjykatën, në atë se gjykatësi “kishte përshpejtuar” procedurat gjyqësore në të mirë të kundërshtarit të tij dhe se ai nuk i kishte zbatuar dispozitat e ligjit procedural në lidhje me ish-gruan e tij në përputhje me dispozitat e nenit 124, (thirrja e dëshmitarëve) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës. Përderisa ankuesi nuk i referohet ndonjë të drejte themelore, përmbajtja e ankesës së tij sugjeron që ajo ka të bëjë me shkeljet e pretenduara të të drejtave të tij sipas nenit 6 të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNj) (dhe nenit 14/16 të Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike – KNDCP).

### **IV. LIGJI**

10. Si një çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar të zbatojë instrumentet e të drejtave të njeriut siç është reflektuar në Konceptin e Përgjegjshmërisë së EULEX-it të datës 29 tetor 2009 në OPLAN të EULEX-it në Kosovë për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe

Politike të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.

11. Para shqyrtimit të ankesës në bazë të bazueshmërisë së saj, Paneli duhet të vendosë nëse do të vazhdojë me të, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullën 29, në lidhje me rregullën 25 të rregullores së punës.
12. Sipas rregullës 25, paragrafi 1, të rregullores së punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat në lidhje me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i Kosovë gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv në sektorët e drejtësisë, policisë dhe doganave.
13. Paneli thekson që ankesa e ankuesit duket se ka të bëjë ekskluzivisht me çështjet e së drejtës familjare të përcaktuara me vendimet gjyqësore të lëshuara nga gjykatat e Kosovës.
14. Ankuesi nuk ka pretenduar se të drejtat e tij janë shkelur ose prekur nga EULEX-i. Për më tepër, ankuesi nuk ka argumentuar, e lëre më treguar se EULEX-i ishte i përfshirë në ndonjë cilësi në çështjet për të cilat është bërë ankesa.
15. Rrjedhimisht, kjo ankesë bie jashtë fushës së mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë dhe për pasojë jashtë kompetencave të Panelit, siç është saktësuar në rregullën 25 të rregullores së punës dhe OPLAN-it të EULEX-it Kosovë (shih *Dekart Shkololli kundër EULEX-it*, 2015-03, 29 shkurt 2016, paragrafi 9; *Qerim Begolli kundër EULEX-it*, 2014-27, 2 shkurt 2015, paragrafi 12, *Mensur Fezaj kundër EULEX-it*, nr. 2014-20, 26 gusht 2014, par. 9-10).

#### **PËR KËTO ARSYE,**

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, në bazë të nenit 29(d) të rregullores së vet të punës dhe prandaj

#### **SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.**

Për Panelin,

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA  
Kryesuese